



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIMAL  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM  
NR 70 DATË 02.12.2021

**MBI MIRATIMIN E SHPREHJES SË DAKORDËSISË DHE MIRATIMIN E FONDIT PËRKATËS PËR ORGANIZIMIN E PROJEKTEVE KULTURORE DHE AKTIVITETEVE PËR FESTAT E FUNDVITIT 2021 NË BASHKINË DIMAL**

Këshilli Bashkiak Dimal në mbledhjen e tij të datës 02.12.2021 duke u bazuar dhe mbështetur në materialin e paraqitur nga Drejtoria Juridike ,Sektori i Arsimit Kulturës dhe Sporteve , pranë Bashkisë Dimal, në mbështetje dhe zbatim të Ligjit Nr 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore "Neni 9, Neni 25 "Funkcionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve Argëtuuese" pika 2 "Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve", Neni 54, Neni 55 ,Ligji 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore "VKB Nr 81 datë 24/12/2020" Mbi Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 dhe Detajimin e Buxhetit të Bashkisë Ura Vajgurore për vitin 2021",

**VENDOSI:**

**Me 13 vota PRO nga 13 Këshilltarë prezentë në mbledhje të miratojë :**

1. Të miratojë : Shprehjen e dakordësisë dhe miratimin e fondit përkatës "Për organizimin e projekteve kulturore dhe aktiviteteve për "Festat e Fundvitit 2021" në Bashkinë Dimal.
2. Fondi përkatës në shumën financiare prej 3,000,000 lekë , për organizimin dhe realizimin e aktivitetit kulturor "Festat e fundvitit në Dimal" do të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Dimal .
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Dimal , Drejtoria Juridike, Drejtoria e Financës, Sektori i Arsimit Kulturës dhe Sporteve në Bashkinë Dimal.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij , sipas parashikimeve të nenit 55 pika 6 të Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" , {i ndryshuar}
5. Bashkëlidhur vendimit : "Propozimi përkatës për realizimin e aktivitetit kulturor "Festat e fundvitit në Dimal"

Kryetar i Këshillit Bashkiak  
Hysen Hoxha

